

Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7 - 55

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektët materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin me rezervë

Siç është paraqitur në shënimin 4.5 të pasqyrave financiare, Banka nuk është në përputhje me kërkesat ligjore për kapitalin rregullator minimal të përcaktuar nga autoriteti mbikqyrës, Banka e Shqipërisë. Më datë 11 shtator 2017, Banka është urdhëruar nga Banka e Shqipërisë të rrisë kapitalin rregullator dhe të ndërpresë veprimtarinë e pranimit të depozitave të reja dhe kredidhënies. Aksionarët kanë rënë dakord të rrisin kapitalin e paguar, por deri në datën 31 dhjetor 2017 ky kontribut nuk është kryer.

Banka ka kryer disa vlerësime paraprake dhe ka dhënë disa informacione shpjeguese në lidhje me standardet, interpretimet dhe ndryshimet e publikuara, por ende jo efektive në lidhje me SNRF 9 "Instrumentat Financiare" por nuk na është vënë në dispozicion ndonjë politike, SPPI teste, metodologji të aprovuar apo ndonjë model mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe as ndonjë metodologji të aprovuar për zhvlerësimin e tyre. Banka vlerëson se për shkak të aktivitetit të kufizuar bankar, ndikimi i aplikimit të SNRF 9 pritet të jetë i vogël në balancat e çeljes më 1 janar 2018. Për shkak se nuk kemi pasur evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe në mungesë të procedurave të tjera alternative, mbi ndikimin që do të kishin sjellë informacionet shpjeguese në pasqyrat financiare, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim nga këto dhënie informacionesh shpjeguese do të ishte i nevojshëm.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje në lidhje me pasiguri materiale për vijimësinë e aktivitetit

Ne tërheqim vëmendjen në përshtatshmërinë e paraqitjeve të bëra në shënimin 2 të pasqyrave financiare në lidhje me aftësinë e njësisë ekonomike për të operuar në bazë të parimit të vijimësisë. Niveli i aktiviteteve të njësisë ekonomike është i ulët, struktura organizative është e reduktuar dhe mund të ndikojë në rrezikun operacional dhe, së bashku me çështje të tjera të paraqitura në shënimin 5 (i) të pasqyrave financiare, këto kushte, tregojnë ekzistencën e pasigurive materiale të cilat mund të hedhin dyshime në lidhje me aftësinë e njësisë ekonomike për të operuar në bazë të parimit të vijimësisë. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullimet që do të rezultojnë nëse njësia ekonomike nuk do të ishte në gjendje për të operuar në bazë të parimit të vijimësisë. Aksionarët janë në proces negociimi me investitorë potencialë për shitjen e aksioneve të Bankës dhe Drejtimit të Bankës beson se aksionarët do të përmbushin së shpejti rekomandimet e Bankës së Shqipërisë dhe për këtë arsye ata kanë përgatitur pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 në bazë të parimit të vijimësisë.

Siç përshkruhet në shënimin 26 Banka ka patur transaksione të rëndësishme me palët e lidhura. Këto transaksione përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të portofolit bruto të huave dhe paradhënies për klientët dhe depozitave ndaj klientëve, e si rrjedhojë ato kanë një impakt të ndjeshëm në pozicionin financiar dhe performancën e Bankës. Shumat me palët e lidhura përfaqësojnë ekspozime të mëdha sipas rregullores së bankës së Shqipërisë, megjithatë ato janë raportuar siç kërkohet nga rregulloret përkatëse.

Opinionin ynë nuk është i modifikuar për sa i përket këtyre çështjeve.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehtë të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Manaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Manaxhimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshëm, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Bankës ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikur gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA sh.p.k.

BDO Albania sh.p.k.

28 mars 2018

Tiranë, Shqipëri

BDO

BDO ALBANIA sh.p.k.

NIPT L02407004C

TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda
Partner Angazhimi



BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2017
(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	13	21,023	21,964
Rezerva e detyrueshme	13	32,847	83,298
Hua për bankat	14	1,221,930	2,201,116
Bono thesari	15	93,718	94,116
Hua dhe paradhënie për klientet	16	269,473	310,876
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	17	1,432	1,911
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	18	137,356	145,194
Aktive të tjera	19	266	358
Totali i aktiveve		1,778,045	2,858,833
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	20	359,083	368,338
Detyrime ndaj klientëve	21	511,744	1,300,934
Detyrime të tjera	22	76,705	78,315
Totali i detyrimeve		947,532	1,747,587
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar i paguar	23	1,318,227	1,318,227
Humbja e akumuluar	23	(487,714)	(206,981)
Totali i kapitalit aksionar		830,513	1,111,246
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		1,778,045	2,858,833

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1-27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i Bankës më 15 mars 2018 dhe u nënshkruan nga përfaqësuesit e saj:

President
Ahmed Sami



Drejtues Ekzekutiv
Shënimë Kamel



4


BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi		25,510	23,017
Shpenzime interesi		(13,316)	(12,227)
Të ardhura neto nga interesi	8	12,194	10,790
Të ardhura nga komisione		537	1,278
Shpenzime për komisione		(833)	(772)
Të ardhura neto nga komisione	9	(296)	506
Të ardhura neto nga veprimtaria valutore		(209,641)	34,377
Të ardhura nga qiraja operative		1,046	1,500
Provigjione për humbje nga huatë	16	418	(58)
Shpenzime administrative	10/11	(76,076)	(75,725)
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi		(8,378)	(9,085)
Të ardhura operative		(292,631)	(48,991)
Fitimi / (humbja) para tatimit		(280,733)	(37,695)
Tatimi mbi fitimin	12	-	-
Fitimi / (humbja) neto për vitin		(280,733)	(37,695)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		(280,733)	(37,695)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1-27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga veprimtaritë operative			
Fitimi / (humbja) neto për vitin		(280,733)	(37,695)
Rregullime për të rakorduar fitimin / (humbjen) neto me paratë e gjeneruara nga veprimtaritë operative			
Amortizimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara	18	7,898	8,446
Amortizimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara	17	479	638
Provizjione për humbjet nga huatë	16	(418)	58
Të ardhura nga interesi	8	(25,510)	(23,017)
Shpenzime interesi	8	13,316	12,227
Shpenzime tatim-fitimi	12	-	-
Flukset e parasë nga veprimtaritë operative para lëvizjeve në kapitalin qarkullues		(284,968)	(39,343)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Rritje në rezervën e detyrueshme (Rritje) / pakësim në huatë dhe paradhëniet për klientët	13	50,451	(54,883)
(Rritje) / pakësim në aktive të tjera	16	41,821	(5,831)
Rritje në detyrime ndaj bankave	19	93	1,740
Rritje në detyrime ndaj klientëve	20	(9,255)	117,694
Pakësim / (Rritje) në tatimin e pagueshëm	21	(789,190)	710,776
Rritje në detyrime të tjera	22	(1,609)	6,824
Interes i përlllogaritur i arkëtueshëm		25,510	23,017
Interes i përlllogaritur i pagueshëm		(13,316)	(12,227)
Paraja e gjeneruar nga veprimtaritë operative		(980,463)	747,767
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerje e bonove të thesarit- të mbajtura deri në maturim	15	398	(959)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	18	(62)	(299)
Rrjedha neto e parasë e përdorur në veprimtaritë investuese		336	(1,258)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese			
Emëtim i kapitalit aksionar		-	-
Pakësim i kapitalit kasionar		-	-
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë financuese		-	-
Rritje në mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj		(980,127)	746,509
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		2,223,080	1,476,571
Efekte të ndryshimit të kursit të këmbimit në balancën e mjeteve monetare të mbajtura në monedha të ndryshme.			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	24	1,242,953	2,223,080

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1-27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

	Kapitali aksionar	Fitim i pashpërndarë / (Humbje të akumuluar)	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	<u>1,318,227</u>	<u>(169,286)</u>	<u>1,148,941</u>
Rritje e kapitalit aksionar	-	-	-
Fitimi / (humbja) neto per vitin	-	(37,695)	(37,695)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	<u>1,318,227</u>	<u>(206,981)</u>	<u>1,111,246</u>
Rritje e kapitalit aksionar	-	-	-
Fitimi / (humbja) neto per vitin	-	(280,733)	(280,733)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	<u>1,318,227</u>	<u>(487,714)</u>	<u>830,513</u>

Pasqyrat e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1-27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a. (këtu e në vazhdim "Banka") është një shoqëri aksionare shqiptare me qendër në Tiranë, e cila operon në tregun bankar, duke siguruar një gamë të gjërë produktesh në shërbime, veçanërisht tranferta nëpërmjet suportit të një rrjeti të gjërë korrespondentësh ndërkombëtare.

Me 31 dhjetor 2017 Banka operonte nga zyra qendrore në Tiranë dhe 1 degë.

Më 31 dhjetor 2017 Banka kishte 24 punonjës (2016: 28 punonjës), duke përfshirë një manaxher të huaj që operon kryesisht në territorin e Shqipërisë.

Banka, e cila është e regjistruar në regjistrin tregtar të gjykatës së Tiranës me vendim nr. 27845, datë 03.06.2002 bazuar në ligjin nr.7638 datë 19.11.1992 "Mbi kompanitë tregtare" dhe është subjekt i ligjit nr. 8269 mbi "Bankën e Shqipërisë" datë 23.12.1997 dhe ligjit nr. 9662 "Mbi Bankat e Republikës së Shqipërisë" datë 18.12.2006.

Më 31 dhjetor 2017 numri i aksioneve në total ishte 14,100 ndarë sipas strukturës së mëposhtme:

Emri	Nr i aksioneve	%
1 Fawzi M.A. Al Kharafi	4,700	33.33%
2 Marzouq N N A Alkharafi	1,030	7.30%
3 Bader N N A Alkharafi	1,030	7.30%
4 Faisal N N A Alkharafi	1,030	7.30%
5 Abdulmohsim J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
6 Loay J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
7 Eyad J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
8 Talal J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
9 Anwar J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
10 Ahmad J.M.A.AL Kharafi	633	4.49%
11 Fawziya Sulaiman A.S.A Al-Rifai	592	4.20%
12 Sabeeka Sa'ad Aljaser	586	4.17%
13 Hetaf N N A Alkharafi	509	3.60%
14 Hebah N N A Alkharafi	509	3.60%
15 Ghalia J.M.A.AL Kharafi	316	2.24%
Total	14,100	100%

2. Bazat e përgatitjes

a. Deklarata e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës së Kreditit të Shqipërisë Sh.a. dhe shënimet shpejguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), interpretimet e nxjerra nga Komiteti Nderkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar ("KNIRF") ose ish Komiteti i Rangut të Interpretimeve, në vijim të kërkesave të nenit 47 të Ligjit nr. 9662 datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligji nr. 9228 date 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqiptar ("Lek") dhe përgatiten mbi bazën e kostos historike përveç disa instrumenteve financiare:

- Instrumentat financiarë derivativë maten me vlerën e tregut;
- Instrumentat financiarë me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes maten me vlerën e tregut;
- Aktivet financiare të vlefshme për shitje maten me vlerën e tregut;
- Investimet në aktive afatgjata materiale maten me vlerën e tregut;
- Detyrimet për t'u paguar maten me vlerën e tregut;

2. Bazat e përgatitjes (vazhdimi)

c. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Bankës). I gjithë informacioni financiar paraqitet në Lek dhe i përafëruar në mijëshe (përveç kur shprehet ndryshe).

d. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar, në qoftë se rishikimi prek vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon njëkohësisht në periudhën raportuese dhe në periudhat e ardhshme. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël që kanë efekt më të konsiderueshëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare përshkruhen në shënime.

3. Politika të rëndësishme kontabël

a. Monedhat e huaja

Në përgatitjen e pasqyrave financiare transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundvitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet dhe detyrimet jo monetare që maten me monedhë të huaj si pasojë e kostos historike, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare të shprehura në monedhë të huaj që deklarohen me vlerë tregu kthehen në Lek Shqiptar me kursin e këmbimit në datën në të cilën u percaktua vlera e tregut.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitura në monedhë të huaj ishin si më poshtë:

	31dhjetor, 2017	31 dhjetor, 2016
Lek/EUR	132.95	135.23
Lek/USD	111.10	128.17
Lek/GBP	149.95	157.56
Lek/CAD	88.64	95.09
Lek/CHF	113.94	126.05

b. Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv, përveç atyre të klasifikuara si të mbajtura për tregtim me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

b. Interesi (vazhdim)

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së një aktivi ose detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave ose shpenzimeve nga interesi mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton arkëtimet ose pagesat e ardhshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër.

Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset e parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, opsionet me parapagim), por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme të kredive. Llogaritja përfshin të gjitha tarifatat dhe përqindjet e paguara ose të arkëtuara ndërmjet palëve të kontratës që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit, kostove të transaksionit dhe të tjera prime ose zbritje.

Në momentin që një aktiv financiar ose një aktiv financiar i ngjashëm i një Banke është zhvlerësuar, të ardhurat nga interesi njihen duke përdorur normën e interesit të përdorur për skontimin e flukseve të ardhshme të parasë me qëllim që të matet humbja nga zhvlerësimi. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar me një bazë të normës së interesit efektiv.

c. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveçse kur kemi të bëjmë me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme në lidhje me fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat tatimore që janë në fuqi në fund të periudhës raportuese, dhe çdo rregullim që i bëhet tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore të përdorur në llogaritjen e fitimit. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme të mëposhtme: njohja fillestare e emrit të mirë, njohja fillestare e aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin kontabël as atë të taksueshëm, dhe diferencat e lidhura me investimet në degë deri në masën që ato nuk do të kthehen në një të ardhme të parashikueshme.

Tatimet e shtyra maten me normat e taksave që priten të zbatohen kundrejt diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet në fuqi ose ato që do të aprovohen deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa ato kanë mundësi të mbulohen nga fitimi i tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca e përkohshme e zbritshme të mund të përdoret. Aktivit tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë të raportimit dhe reduktohet në një masë të tillë që nuk mund të jetë më e mundshme të realizohet përfitimi në lidhje me taksat. Tatimet shtesë mbi të ardhurat që lindin nga shpërndarja e dividendeve njihen në të njëjtën kohë që njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

d. Aktivët dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka njeh një aktiv financiar ose detyrim financiar në bilanc në datën kur Banka bëhet palë e dipozitave kontraktuale të instrumentit.

Investimet të mbajtura deri në maturim dhe huatë dhe të arkëtueshmet njihen në datën e vendosjes, kur një aktiv dërgohet tek ose nga një njësi.

(ii) Ç'regjistrimi

Banka ç'regjiston një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që vijnë nga aktivi skadojnë ose nëse Banka transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar.

Çdo interes në aktive financiare të transferueshme, që përfitohet ose mbahet nga Banka, njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nga Banka nëse detyrimet kontraktuale të Bankës mbarojnë, janë anuluar ose kanë skaduar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk ç'regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve. Në transaksione në të cilat Banka nuk mban dhe nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, ajo e ç'regjiston aktivin nëse kontrolli mbi të humbet (shih shënimin 4).

(iii) Kompensimi

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma raportohet neto në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka një të drejtë të përforcuar ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe ka për qëllim t'i sistemojë mbi një bazë neto, ose të përfitojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi një bazë neto vetëm kur kjo lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet ose humbjet që lindin nga grupe transaksionesh të ngjashme, si për shembull aktiviteti tregtar bankar.

(iv) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(v) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, janë zhvlerësuar.

Aktivët financiare zhvlerësohen dhe rënia në vlerë ndodh kur ka evidenca objektive të rënies në vlerë si rezultat i një ose më shumë ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit ("një ngjarje humbje") dhe që ngjarja që sjell humbje (ose ngjarjet) ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit financiar ose aktiveve financiare të Bankës, të cilat mund të maten me besueshmëri.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

d. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Kriteret që përdor Banka për të përcaktuar nëse ka evidenca objektive për një rënie në vlerë përfshijnë:

- Shkelje e pagesave kontraktuale të principalit ose interesit;
- Vështirësi në shlyerje nga huamarrësi (për shembull, raporti i kapitalit, të ardhurat neto nga përqindjet e shitjeve);
- Prishje të kontratës dhe kushteve të huadhënies;
- Fillimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësim i pozicionit konkurrues të huamarrësit;
- Përkeqësim i vlerës së kolateralit;

Periudha e vlerësimit midis një humbje dhe identifikimit të saj përcaktohet nga drejtimi për çdo humbje të identifikuar. Në përgjithësi, periudha varion midis 3 dhe 12 muajve; në raste të veçanta garantohen periudha më të gjata. Fillimisht Banka vlerëson nëse ekzistojnë prova objektive për humbje të vlerës në mënyre individuale për aktive që janë individualisht të rëndësishme. Në rast se Banka përcakton që nuk ekzistojnë prova objektive për humbje vlere të një aktivi financiar të vlerësuar individualisht, nëse është i rëndësishëm ose jo, Banka i përfshin këto në aktive me karakter të ngjajshëm financiar duke llogaritur riskun e kredisë dhe i vlerëson në mënyrë të përbashkët për qëllim të vlerësimit të humbjes së vlerës.

Aktivitet të cilat vlerësohen individualisht për humbje vlerë dhe për të cilën ekziston një humbje e vlerës që vazhdon të njihet, nuk përfshihen në një vlerësim të përbashkët të humbjes. Shuma e humbjes matet si diferenca ndërmjet shumës së mbartur të aktivitet dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kreditit që nuk janë ndikuar) të zbritura nga norma fillestare e interesit të aktivitet financiar. Shuma e mbartur e aktivitet ulet nëpërmjet një llogarie lejuese dhe shuma njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Në rast se një hua ose një investim deri në maturim ka një normë interesi të ndryshueshme, norma e uljes për të matur çdo humbje nga dëmtimi është norma efektive aktuale e interesit e përcaktuar nga kontrata.

(vi) Përcaktimi me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Banka i klasifikon aktivitet dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur:

- aktivitet ose detyrimet manaxhohen, vlerësohen dhe raportohen mbi bazën e vlerës së drejtë;
- përcaktimi eliminon ose ul ndjeshëm gabimet në kontabilitet të cilat mund të lindnin; ose
- aktivi ose detyrimi përmban një derivativ që ndryshon ndjeshëm flukset e parasë të kërkuara si pasojë e kontratës.

e. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj paraqiten me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f. Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet për klientët janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudha afatshkurtra. Kur Banka është qiradhënës në një kontratë qiraje që kryesisht transferon të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e një aktivi tek qiramarrësi, marrëveshja klasifikohet si hua dhe paradhënie.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht njihen me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

g. Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë fillimisht llogariten me vlerën e drejtë plus kosto direkte rritëse të transaksionit, në rastin e investimeve në letra me vlerë që nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimeve të tyre si të mbajtura deri në maturim, me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje, ose si të vlefshëm për shitje.

Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse të përcaktuara dhe me maturitet fiks, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim dhe që nuk janë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshëm për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim janë mbartur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Cdo shitje apo riklasifikim i një shume të konsiderueshme të investimeve që mbahen deri në maturim larg datës së maturimit do të rezultonte në një riklasifikim të të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe do të pengonte Bankën në klasifikimin e investimeve si të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe dy vitet në vijim.

h. Qiratë

Banka është qiramarrësi

Qiratë ku është përfshirë Banka janë kryesisht qira operative. Pagesa totale të bëra nën qiratë operative njihen si shpezime të tjera operative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë.

Kur një qira operative përfundon përpara se të mbarojë afati i qirasë, çdo pagesë që duhet të bëjë qiradhënësi si penalitet njihet si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh përfundimi i kontratës.

i. Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur. Pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje që kanë jetë-gjatësi të ndryshme kontabilizohen si elemente të veçanta (pjesë përbërëse) të aktiveve afatgjata materiale.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

i. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit, nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen, që i atribuohen atij elementi, do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së vlerësuar të çdo aktivi afatgjatë material. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për kohën më të shkurtër të qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit.

Toka nuk zhvlerësohet. Metoda e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Në aktivet afatgjata materiale është e përfshirë dhe ndërtesa në të cilën janë vendosur Zyrat Qëndrore të Bankës dhe Dega e Tiranës. Ndërtesa zhvlerësohet me anën e metodës lineare, gjatë jetës së vlerësuar, me normë vjetore 5%. Mobiljet e zyrës dhe paisjet paraqiten me kosot minus zhvlerësimin e akumuluar, e cila llogaritet me anën e metodës lineare gjatë jetës së vlerësuar të aktiveve.

Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%
Mobilje zyre	10%- 25%
Paisje zyre	10% -25%
Paisje elektronike dhe informatike	25%

j. Aktive afatgjata jomateriale

Programet kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së vlerësuar të dobishme të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ai është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është tre deri në pesë vjet. Norma vjetore e amortizimit është 25%.

k. Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Banka rishikon në fund të çdo periudhe raportuese vlerën kontabël neto të aktiveve jo financiare për të përcaktuar nëse ka të dhëna se këto aktive janë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, matet shuma e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet masa e zhvlerësimit (nëse ka). Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Nëse shuma e rikuperueshme e një aktivi vlerësohet të jetë më e vogël se vlera kontabël neto, vlera kontabël neto e aktivit zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, përveç nëse aktivi mbahet me shumë të rivlerësuar, rast në të cilin humbja nga zhvlerësimi njihet si pakësim i rivlerësimit. Kur anulohet një humbje nga zhvlerësimi, vlera kontabël neto e aktivit rritet deri në vlerën e rishikuar të rikuperueshme, por jo aq sa vlera neto kontabël e rritur të tejkalojë vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi në vitet e mëparshme.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

k. Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare (vazhdim)

Një anulim i humbjes nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, përveç se kur aktivi mbahet me vlerën e rivlerësuar rast në të cilin anulimi i humbjes nga rënia në vlerë njihet si një rritje nga rivlerësimi.

Në çdo datë raportimi kompania rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet rënia në vlerë. Vlera e rikuperueshme e një aktivit ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohej rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivit apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Humbjet nga rënia, që janë njohur në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka evidence që humbja është ulur ose nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë regjistrohet në masën që vlera kontabël e një aktivit nuk tejkalon vlerën e tij kontabël neto nga zhvlerësimi ose amortizimi që do të ishte përcaktuar, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga rënia në vlerë.

l. Depozitat, Letra me vlere te borxhit, Detyrimet e Varura

Depozitat janë burimi i financimit të borxheve të bankës. Depozitat, letrat e borxhit të lëshuara dhe detyrimet e varura, fillimisht maten sipas vlerës së drejtë plus koston e transaksionit, më pas mbi koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, përveç rasteve kur Banka zgjedh të mbajë detyrimet në vlerën e drejtën nëpërmjet fitimit ose humbjes.

m. Provigjionet

Provigjionet njihen në rastet kur, si rezultat i një ngjarje të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Provigjionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë interesi para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim. Një provigjion për ristrukturim njihet kur Banka ka aprovuar në detaje dhe formalisht planin e ristrukturimit dhe në rastet kur ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet e ardhshme operationale nuk janë kusht. Provigjionet për kontratat delikate njihen kur përfitimet e pritshme nga Banka për kontratën në fjalë, janë më të ulëta se kosto e pashmangshme në qasjen e detyrimeve sipas kontratës.

Provigjionet maten në vlerën e tyre aktuale me koston më të ulët të pritshme nga përfundimi i kontratës dhe kosto neto e parashikuar në rast vazhdimi të kontratës. Para paraqitjes së një provigjioni, Banka njeh çdo humbje ngë rënia e vlerës së atij aktivit sipas kontratës.

n. Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata të cilat kanë si kusht që Banka të bëjë pagesa për të rimbursuar mbajtësin për çdo humbje e cila ndodh për shkak të dështimit të huamarrësit në bërjen e pagesa sipas afatit në përputhje me termat huasë. Detyrimet financiare të garantuesit fillimisht njihen në vlerën e drejtë, vlera e drejtë amortizohet sipas jetëgjatësisë së garantuesit. Detyrimi i garantuesit mbartet sipas vlerës më të lartë të këtij amortizimi dhe vlerës aktuale të çdo pagese të pritshme. Garantuesit financiarë janë të përfshirë në detyrimet e tjera.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

o. Përfitimet e punëmarrësve

(i) Kontritubet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Banka derdh kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat përmbajnë përfitime pensioni për punonjësit deri në daljen e tyre në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse në hartimin e minimumit ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh për pension. Kontributi i Bankës për përfitimet e planit të pensioneve paraqiten në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Leja vjetore e paguar

Banka njih si detyrim shumën e pazbritur të kostove të vlerësuara në lidhje me lejen vjetore që pritet t'u paguhet në shkëmbim të shërbimit punëmarrësve për periudhën e punësimit.

p. Kapitali dhe Rezervat

Kosto e emetimit të aksioneve

Kostot shtesë të cilat lidhen direkt me emetimin e instrumentave të kapitalit i zbriten vlerës fillestare të njohjes të instrumentit të kapitalit.

q. Raportimi sipas segmenteve

Një segment është një komponent i dallueshëm i Bankës ku ajo është e angazuar në ofrimin e produkteve ose shërbimeve (segment biznesi), ose në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në një zonë ekonomike të caktuar (segment gjeografik), i cili është subjekt i rreziqeve dhe përfitimeve që janë të ndryshme nga ato të segmenteve të tjera. Format i primar i Bankës për raportimin e segmenteve bazohet në segmentet e biznesit.

r. Standardet dhe Interpretimet

(i) Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhën aktuale

Amendimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretime të lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar janë efektive për periudhën aktuale:

- Amendamentet e SNK 12 "Tatim fitimi" - Njohja e aktivitetit tatimor të shtyre për humbjet e përcaktuara (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2017),
- Amendamentet e SNK IAS 7 "Pasqyra e flukseve të parase" (efektive 1 janar 2017)
- Përmirësimet vjetore në SNRF (periudha 2012-2014)

Përshtatja e këtyre amendamenteve me standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndryshime në politikat kontabël të Bankës.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi

Ne datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet e Standardeve në vijim janë publikuar por nuk janë ende efektive dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- SNRF 9 “Instrumentat Financiare” (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2018),
- SNRF 15 “Të Ardhura nga Kontratat me Kliente” (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2018),
- SNRF 16 “Qirate” (efektive për periudhat vjetore filluar në ose pas datës 1 janar 2019),
- SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit” (efektive për periudhat vjetore filluar në ose pas datës 1 janar 2021),
- Amendamentet e SNRF 15 “Te Ardhura nga Kontratat me Kliente” Sqarimet (efektive 1 janar 2018),
- Amendamentet e SNRF 2, “Pagesat me aksione” Sqarimet dhe matja (efektive 1 janar 2018)
- Amendamentet e SNK 40, “Aktivet materiale afategjata të investuara” transferimi i pronës (efektive 1 janar 2018)
- INRF 22, “Transaksionet në monedhë të huaj dhe njohja e paradhënies” (efektive 1 janar 2018)

Banka ka zgjedhur të mos i zbatojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës së tyre të hyrjes në fuqi. Me përjashtim të efekteve të SNRF 9, Banka parashikon që zbatimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj në periudhën e zbatimit fillestar.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

SNRF 9 Instrumenta Financiare

Ndikimet financiare të aplikimit të SNRF 9

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka publikuar SNRF 9 "Instrumentet Financiare" në korrik të vitit 2014. Standardi zëvendëson SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe matja" dhe është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, aplikimi i mëparshëm është i lejuar. Banka e Kreditit e Shqipërisë ('Banka') do të aplikojë SNRF 9 nga data 1 janar 2018.

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 do të zbatohen në mënyrë retrospektive. Banka do të zgjedhë alternativën e përjashtimit e cila e lejon të mos bëjë riparaqitjen e pasqyrave financiare të periudhave të mëparshme. Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 do të njihen në fitimet e pashpërndara dhe rezervat e tjera më 1 janar 2018.

Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:

- përcaktimin e modelit të biznesit brenda të cilit është mbajtur një aktiv financiar;
- përcaktimin dhe revokimin i përcaktimeve të mëparshme të disa aktiveve financiare dhe pasiveve financiare të matura sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- përcaktimin e disa investimeve në instrumente të kapitalit neto që nuk mbahen për tregtim të matura sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Për një detyrim financiar të caktuar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes,
- përcaktimi nëse paraqet efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit financiar në të ardhurave të tjera përmbledhëse, do të krijojë ose zgjerojë një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje.

Banka e Kreditit e Shqipërisë është një bankë e vogël dhe ka pasur për vite veprimtari bankare të kufizuar. Niveli i aktivitetit të Bankës nuk ka ndryshuar që kur aksionarët kanë vendosur të shesin aksionet e tyre. Prandaj, Banka synon mbajtjen e nivelit të ulët të aktiviteteve të biznesit dhe strukturën relativisht të thjeshtë. Më 31 dhjetor 2017 Banka kishte vetëm një ekspozim i cili u mbyll gjatë muajit shkurt 2018 dhe nuk kishte histori të humbjeve nga kreditë për shkak të aktivitetit të kufizuar.

Bazuar në vlerësimin e Bankës në datën e sotme, konsiderohet se standardi i ri do të ketë një ndikim minimal në balancat hapëse më 1 janar 2018.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) *Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)*

Klasifikimi dhe matja

Aktivët financiarë

Nga perspektiva e klasifikimit dhe matjes, standardi i ri kërkon që instrumentet e borxhit të klasifikohen në bazë të modelit të tyre të biznesit dhe karakteristikave të flukseve të mjeteve monetare, në vend që të bazohen në arsyet e çdo blerje. SNRF 9 është kombinim i tre kategorive të klasifikimit: të matura me kosto të amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Ato zëvendësojnë kategoritë e klasifikimit të SNK 39, të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të vlefshme për shitje, të mbajtura për tregtim dhe të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. SNRF 9 kërkon një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli.

Një instrument borxhi matet me koston e amortizuar vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes:

- është mbajtur sipas një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale; dhe
- flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI).

Një instrument borxhi matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.:

- mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare; dhe
- flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI).

Të gjitha instrumentet e tjerë të borxhit mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

SNRF 9 lejon njësitë ekonomike që, që në njohjen fillestare të përcaktojnë në mënyrë të pakthyeshme instrumentet që kualifikohen për koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në rast se nëse ndodh kjo, eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjen e matjes ose të njohjes.

Instrumentet e kapitalit duhet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përveç nëse zbatohen standardet e tjera të SNRF ose janë të përcaktuara në mënyrë të përvokueshme me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, pa riklasifikim të mëvonshëm të fitimeve ose humbjeve në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

Detyrimet financiare

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin e detyrimeve financiare. Megjithatë, sipas SNK 39, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve financiare të përcaktuara si me vlerën e drejtë nëpërmjet të fitimit ose humbjes njihen në fitim ose humbje, ndërsa sipas SNRF 9 ndryshimet e vlerës së drejtë që i atribuohen rrezikut të kredisë do të paraqiten në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe vlera e mbetur do të paraqitet në fitim ose humbje, përveç nëse shfaqet një mospërputhje kontabël në fitimit ose humbjes. Që nga 1 janari 2018, asnjë detyrim i Bankës nuk do të përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet të fitimit ose humbjes.

Pas përfundimit të vlerësimit fillestar, Banka parashikon se në datën e aplikimit të SNRF 9, ndikimi i këtyre ndryshimeve do të jetë i vogël për shkak të veprimtarisë së kufizuar të Bankës.

Zhvlerësimi

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të ndodhura” sipas SNK 39 me modelin e “humbjeve të pritshme”. Ndryshimi nga humbjet e ndodhura në ato të pritshme do të kërkojë një gjykim të konsiderueshëm mbi faktorë të ndryshëm të përdorur në llogaritjen e humbjeve të pritshme, të tilla si, si skenarët makroekonomikë ndikojnë në llogaritjen e humbjeve të pritshme. Modeli i ri i zhvlerësimit do të aplikohet për aktivet financiare që janë instrumente borxhi (përfshirë huatë për klientët) të matura me koston e amortizuar të vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, llogaritë e arkëtueshme të qirasë, angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit. Zbatimi i kërkesave për zhvlerësim sipas SNRF 9 mund të rrisë luhatshmërinë në fitimin dhe humbjen e Bankës.

Përkufizimi i aktiveve financiare me probleme

Bazuar në politkat e saj të brendshme, Banka konsideron që një aktiv financiarë është në me probleme kur:

- Huamarrësi është në vonesë për më shumë se 90 ditë , ose
- Huamarrësi konsiderohet se nuk ka gjasa të paguajë.

Në vlerësimin nëse një huamarrës nuk ka gjasa të paguajë, Banka merr në konsideratë treguesit cilësorë dhe sasiorë, si p.sh. peridha në vonesë, raportet e borxhit dhe kapitalit, rrethanat e tregut dhe të dhëna të tjera të marra nga burime të brendshme ose të jashtme. Për korporatat dhe Grupin e Klientëve të Lidhur konsiderohet se nëse një ekspozim është me probleme, të gjitha ekspozimet e tjera ndaj asaj kundërpattie janë gjithashtu me probleme. Frekuencat e shpeshta të problemeve brenda një viti, do të trajtohen si një ngjarje e vetme. Një ekspozim me probleme do të konsiderohet si i përmisuar nëse është shlyer detyrimi i plotë, brenda 12 muajve nga data e shfaqjes së problemit dhe pa ndonjë humbje për Bankën.

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

Përkufizimi i aktiveve financiare me probleme (vazhdim)

SNRF 9 kërkon që Banka të aplikojë modele tranzicioni, të zhvilluara në bazë të të dhënave historike, për të parashikuar zhvillimin e shkallës së rrezikut për periudha që kalojnë një vit kalendarik. Analiza mbi ndryshimin e klasifikimit të kredive për shkak të rrezikut të përgjithshëm përfshin identifikimin dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet ndryshimeve në normat e mosshlyerjes dhe ndryshimeve në faktorët kryesorë makroekonomikë.

SNRF 9 kërkon që Banka të përdorë këto parashikime për të përshtatur vlerësimet e saj të probabilitetit të shfaqjes së problemeve dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë në humbjen e pritshme të kredisë (ECL) gjatë jetëgjatësisë.

Rritje e ndjeshme në rrezikun e kredisë

Për të përcaktuar nëse rreziku i mosshlyerjes nga një ekspozim është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka merr në konsideratë informacione relevante, të arsyeshme dhe të vërteta në baza të vazhdueshme. Supozimet duhet të marrin në konsideratë përvojën historike të Bankës dhe një gjykim profesional duke përfshirë pritshmëritë e ardhshme.

Kriteret e përshkallëzimit të vlerësimit

Në përputhje me kërkesat e SNRF 9, Banka do të aplikojë kriteret e mëposhtme të përshkallëzimit:

Faza	Kriteret	vlerësime të humbjes së pritshme të kredisë (ECL)
1	Ekspozim jo në vonesë dhe pa rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë	humbje të pritshme të kredisë në 12 muajt e ardhshëm
2	Ekspozim jo në vonesë por me rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë	Humbje e pritshme e kredisë në jetëgjatësinë e saj
3	Ekspozim në vonesë / me probleme	Humbje e pritshme e kredisë në jetëgjatësinë e saj

3 Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

r. Standardet dhe Interpretimet (vazhdim)

(ii) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

Matja/ Vlerësimi i humbjes së pritshme të kredisë

Sipas SNRF 9, llogaritjet e humbjeve të pritshme të kredive (ECL) bazohen në tre komponentë kryesorë:

- probabiliteti i mosshlyerjes (PD),
- humbja nga mosshlyerja (LGD); dhe
- ekspozimi ndaj mosshlyerjes (EAD).

Secili komponent rrjedh nga modelet e gjeneruara nga brenda Bankës. Modelet zhvillohen me metoda statistikore dhe / ose gjykime të ekspertëve të mbështetura mbi të dhënat historike dhe të përshtatura me efektet e pritshme makroekonomike.

PD-të e Bankës dhe strukturat e afateve të PD-së bazohen në faktorë sasiore dhe cilësorë dhe në disa raste përdoren vlerësimet të jashtme. PD-të rivlerësohen në baza të rregullta me frekuenca të ndryshme në varësi të llojit të kundërpartisë dhe / ose ekspozimit.

LGD është vlerësimi i humbjes i kushtëzuar nga mosshlyerja në kohë. Banka ndan LGD në tre komponentë; probabilitetin e kurimit, shumën të arkëtueshme nga ekzekutimi i kolateralit dhe ndonjë shumë që mund të rikuperohet nga pjesa e pasiguar e ekspozimit. Vlerësimi i shumave që mund të arkëtohen nga kolaterali është rezultat i llogaritjes së algoritmeve nga Banka, ku mund të aplikohen rregullime të ndryshme në varësi të kolateralit. Modele të tilla bazohen në gjykimin e ekspertëve, mbështetur mbi të dhënat historike, dhe marrin parasysh kostot dhe vlerën në kohë të parasë. Rregullime të ndryshme mund të aplikohen për skenarë të ndryshëm makroekonomikë në llogaritjet ECL.

EAD përfaqëson ekspozimin e pritshëm në rast të një mosshlyerje. Për një ekspozim të caktuar, Banka e llogarit EAD nga skema e amortizimit kontraktual dhe duke marrë parasysh mundësinë e parapagimeve, tërheqjeve, rivendosjeve, zgjatjeve dhe përdorimit të fondeve të papërdorura, për periudhën deri në mosshlyerje. Këto vlerësime paraprake, të cilat bazohen në vërtetimet historike dhe parashikimet e ardhshme, zbatohen ndryshe për çdo tip ekspozimi. Banka llogarit ECL duke marrë në konsideratë rrezikun e mosshlyerjes gjatë një periudhe maksimale kontraktuale (duke përfshirë edhe ndonjë periudhë zgjatjeje) mbi të cilën ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie apo kredie ose garancie.

Pritshmëritë nga impakti i zhvlerësimit

Duke filluar nga 1 janari 2018, për shkak të aktivitetit të kufizuar bankar, ndikimi i zbatimit të SNRF 9 pritet të jetë minimal.

Informacione shpjeguese

SNRF 9 do të kërkojë informacione të zgjeruara shpjeguese, në veçanti për kontabilitetin, rrezikun e kredisë dhe ECL që do të përfshihen në periudhën e parë të raportimit të Bankës pas implementimit të standardit. Banka e konsideron si të domosdoshëm hartimin, implementimin dhe testimin e metodologjive dhe modeleve për të përmbushur kërkesat e këtij standardi.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Hyrje

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë si:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe kapitalit.

Kuadri i manaxhimit të rreziqeve

Këshilli Drejtues ka si përgjegjësi të përgjithshme themelimin dhe mbikqyrjen e strukturës së manaxhimit të rrezikut të Bankës. Këshilli ka krijuar Komitetin e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO) dhe Komitetin e Rrezikut të kredisë, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në pjesët e tyre përkatëse. Secili prej Bordeve ka anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv të cilët raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues për aktivitetin e tyre.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Banka, për të përcaktuar limite dhe kontrole të përshtatshme dhe për ti monitoruar ato.

Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produkt dhe shërbimet e ofruara.

Banka nëpërmjet trajnimeve, standardeve dhe procedurave të manaxhimit, ka si qëllim zhvillimin e një ambjenti kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit kuptojnë rolin dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së politikave dhe procedurave për manaxhimin e rrezikut të Bankës dhe për rishikimin e përshtatshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës mbështetet për këto funksione nga Auditimi i Brendshëm. Auditimi i brendshëm kryen rishikime të rregullta dhe sipas nevojave imediate për kontrollet dhe procedurat e manaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave raportohen tek Komiteti i Auditimit.

4.1 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient ose një palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga mosarkëtimi i kredive dhe paradhënieve dhënë klientëve apo bankave dhe investimet në letrat me vlerë.

Për qëllime raportimi të rrezikut të manaxhimit, Banka i konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Këshilli Drejtues është përgjegjës për manaxhimin e rrezikut të kredisë. Departamenti i rrezikut të kredive, duke raportuar tek Këshilli Drejtues, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë, kurse i gjithë manaxhimi i rrezikut të kredive përshin:

- Formulimin e politikave të kredisë, kërkesat e mbulimit të kolateralit, vlerësimin e kredisë, nivelin e rrezikut dhe raportimin e tij, dokumentat dhe procedurat ligjore dhe përputhja me kërkesat rregullatore dhe statutoare.

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

- Krijimin e një strukture të autorizuar për aprovimin dhe rinovimin e kredive. Limiti i autorizimit i alokohet njësisë së biznesit dhe oficerëve të kredisë. Kredi më të mëdha kërkojnë aprovim nga departamenti i kredisë, drejtuesi i departamentit të kredisë, Komiteti i Kredisë ose Këshilli Drejtues sipas rastit.
- Rishikimi dhe vlerësimi i rrezikut të kreditimit. Departamenti i Kredisë të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet që kalojnë limitet e përcaktuara, përpara se të kontaktohet me klientët nga njësia përkatëse e biznesit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces të rishikimi.
- Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit ndaj palëve , gjeografikisht dhe industrive (për huatë dhe paradhëniet), dhe nga emetuesi , fashat e klasifikimit të kreditueshmërisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për letrat me vlerë të investimit).
- Zhvillimi dhe mbajtja nën kontroll e nivelit të rrezikut sipas kategorive ekspozuese në lidhje me nivelin e rrezikut ndaj humbjeve financiare dhe në fokus të rrezikut përkatës. Sistemi i përcaktimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar rënien në vlerë nga provigjionimi kundrejt shfaqjes ndaj rrezikut të kredive të vecanta. Struktura aktuale e nivelit të rrezikut përbëhet nga katër nivele të cilat reflektojnë rrezikun përkatës dhe gadishmërinë e kolateralit ose ndonjë rreziku tjetër. Përgjegjësia për të përcaktuar nivelin e rrezikut bie mbi zbatuesin / këshillin aprovues final. Nivelet e rrezikut janë objekt i rregullt rishikimi nga Banka.
- Rishikimi i përputhshmërisë i njësive të bankës me limitet e ekspozimit të rëna dakord, duke përfshirë dhe ato për industri të përzgjedhura, rreziku e shtetit dhe llojet e produkteve.
- Dhënia e këshillave, udhëzimeve dhe aftësive specifike njësive të biznesit për të promovuar praktikat më të mira për menaxhimin e rrezikut të kredive në Bankë.
- Departamenti i manaxhimit të rrezikut të kredisë është i detyruar të implementojë politika dhe procedura kreditimi për Bankën, me autoritet aprovimi të deleguar nga Komiteti i Kredisë së Bankës. Departamenti i manaxhimit të rrezikut të kredisë ka staf menaxherial i cili raporton për të gjitha çështjet e kredive tek Këshilli Drejtues i Bankës. Çdo njësi e Bankës është përgjegjëse për kualitetin dhe performancën e portofolit të kredive dhe për monitorimin dhe kontrollimin e të gjitha rreziqeve e portofoli përkatës, duke përfshirë dhe ato me aprovim qëndror. Kontrollat e rregullta të rrezikut të kreditimit dhe procedurave të kreditimit ndërmerren nga Auditi i Brendshëm.

Ekspozimi ndaj Rrezikut të Kredive

Portofoli i Bankës më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është i ekspozuar si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Hua dhe paradhënie të dhëna Bankave dhe Institucioneve Financiare	1,242,953	2,223,080
Investime në Letra me Vlerë	93,718	94,116
Hua dhe paradhënie për Klientët	269,473	310,876
Total	1,606,144	2,628,072

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Sistemi i Vlerësimit

Banka ka një sistem vlerësimi me qëllim klasifikimin e aktiveve financiare duke u bazuar mbi performancën e tyre si më poshtë:

Të identifikuar kolektivisht: Niveli 1 Mirë

Të identifikuar individualisht: Niveli 2 I Pranueshëm, Niveli 3 në Monitorim, Niveli 4 i Pa tolerueshëm

(i) Kreditë në vonesë por që nuk mbartin rrezikun e zhvlerësimit

Huatë dhe letrat me vlerë ku interesi kontraktual ose pagesat e principalit e kanë kaluar afatin jo më shumë se 5 ditë por që Banka beson që zhvlerësimi nuk është i nevojshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të vendosur dhe/ose faza e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës. Këto kredi klasifikohen në nivelin 1 të sistemit të brendshëm të klasifikimit të Bankës.

(ii) Huatë në vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht

Për huatë dhe letrat me vlerë të cilave interesi kontraktuar ose pagesat e principalit i ka kaluar afati jo më shumë se 30 dite, Banka beson se do të ishte më përshtatshme një zhvlerësim kolektiv 5%. Këto hua janë vlerësuar në nivelin 2 në sistemin e brendshëm të Bankës në vlerësimin e rrezikut.

(iii) Kreditë e zhvlerësuara individualisht

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara janë hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton që është e pamundur që ajo të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin e duhur sipas kushteve të kontraktuara të marrëveshjes së kredisë / letrave me vlerë. Këto hua janë klasifikuar në nivelet 3 dhe 4 sipas në sistemin e brendshëm të Bankës në vlerësimin e rrezikut.

Huatë dhe paradhëniet për institucionet financiare janë të paraqitura si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Brënda afatit dhe pa zhvlerësim		
- Niveli 1	1,242,953	2,223,080
Me vonesë dhe të vlerësuara kolektivisht		
- Niveli 2	-	-
Kredi dhe Paradhënie të vlerësuara individualisht		
- Niveli 3	-	-
- Niveli 4	-	-
Totali	1,242,953	2,223,080

Investimet në portofolin e Letrave me Vlerë dhe Rreziku Përkates më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Brënda afateve dhe pa zhvlerësim		
- Niveli 1	93,718	94,116
Me vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht		
- Niveli 2	-	-
Kredi dhe paradhën te zhvlerësuara individualisht		
- Niveli 3	-	-
- Niveli 4	-	-
Total	93,718	94,116

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

(iii) Kreditë e zhvlerësuara individualisht (vazhdim)

Huatë dhe Paradhëniet për klientët të ndara sipas llojit dhe afatit 31 dhjetor 2017 të detajuara si më poshtë:

	Tregtare	Individë
Brënda afatit dhe pa zhvlerësim		
Niveli 1	-	-
Me vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht		
Niveli 2	269,473	-
Kredi dhe Paradhënie të zhvlerësuara Individualisht		
Niveli 3	-	-
Niveli 4	-	-
Total	269,473	-

Huatë dhe paradhëniet për klientët të ndara sipas llojit dhe afatit 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	Tregtare	Individë
Brënda afateve dhe pa zhvlerësim		
Niveli 1	-	-
Me vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht		
Niveli 2	310,876	-
Kredi dhe Paradhënie të zhvlerësuara Individualisht		
Niveli 3	-	-
Niveli 4	-	-
Total	310,876	-

(iv) Zbritjet për rivlerësim

Banka krijon një provigjion për humbjet nga rënia në vlerë që përfaqëson vlerësimin e humbjeve të ndodhura në portofolin e huasë. Komponentët kryesorë të këtij provigjioni janë humbjet e veçanta të cilat lidhen me ekspozimet individualisht të rëndësishme dhe humbjet kolektive të vendosura nga Banka për hua të ngjashme në lidhje me humbjet që kanë ndodhur por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

(v) Politika e fshirjes së aktiveve fikse

Banka fshin një hua/ leter me vlerë (dhe çdo provigjion për zhvlerësim) kur Departamenti Kredive përcakton se huaja ose letra me vlerë është e pa-arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsiderat të informacione si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit / emetuesit të tillë që huamarrësi / emetuesi nuk mund të paguajë detyrimin , ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të paguar të gjithë ekspozimin . Për vlera të vogla të huave standarde vendimet përgjithësisht bazohen në statusin e më parshëm të produktit .

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

(v) Politika e fshirjes së aktiveve fikse (vazhdim)

Analiza e shumës neto dhe bruto për nivelin e zhvlerësimeve të aktiveve 31 dhjetor 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Tregtare	Individë
Brënda afateve dhe pa zhvlerësim		
Niveli 1	-	-
Me vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht		
Niveli 2	2,722	-
Kredi dhe Paradhënie të zhvlerësuara Individualisht		
Niveli 3	-	-
Niveli 4	-	-
Total	2,722	-

Analiza e shumave bruto dhe neto për vlerësimin e nivelit të rrezikut 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	Tregtare	Individë
Brënda afateve dhe pa zhvlerësim		
Niveli 1	-	-
Me vonesë dhe të zhvlerësuara kolektivisht		
Niveli 2	3,140	-
Kredi dhe Paradhënie të zhvlerësuara Individualisht		
Niveli 3	-	-
Niveli 4	-	-
Total	3,140	-

(vi) Monitorimi i Kolateralit

Banka mban kolateralin përkundrejt huave dhe paradhënies të klientit në formë pengu mbi pronën, letrat me vlerë të regjistruara për aktivet dhe garancitë. Vlerësimi i vlerës së drejtë është i bazuar mbi vlerën e kolateralit të siguruar në momentin e huamarrjes dhe përgjithësisht nuk azhornohehet përveç rasteve kur huaja rivlerësohet. Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet për banka. Kolaterali zakonisht nuk mbahet përkundrejt investimeve mbi letrat me vlerë dhe një kolateral i tillë nuk është mbajtur më 31 dhjetor 2017.

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

(vi) Monitorimi i Kolateralit (vazhdim)

Prezantimi i kolateralit i mbajtur për huatë dhe paradhëniet e klientëve më 31 dhjetor 2017, i detajuar si më poshtë:

	Huatë dhe paradhëniet për klientët	Huatë dhe paradhëniet për institucionet financiare	Investime për Letra me Vlerë	Qira Financiare
Brënda afatit dhe pa zhvlerësim				
<u>Niveli 2</u>	<u>181,892</u>	-	-	-
Kolateral në para	181,892	-	-	-
Vetura	-	-	-	-
Totali	<u>181,892</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>

Kolaterali i mbajtur për huatë dhe paradhëniet e klientëve më 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	Huatë dhe paradhëniet për klientët	Huatë dhe paradhëniet për Institucionet Financiare	Investime për Letra me Vlerë	Qera Financiare
Brënda afatit dhe pa zhvlerësim				
<u>Niveli 2</u>	<u>194,365</u>	-	-	-
Kolateral në para	194,365	-	-	-
Vetura	-	-	-	-
Totali	<u>194,365</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre.

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit

Mënyra që ndjek Banka për administrimin e likuiditetit është duke siguruar, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e saj.

Thesari merr informacion nga njësitë e Bankës në lidhje me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe detaje të tjera të fluskeve të mjeteve monetare të pritshme si rezultat i biznesit në të ardhmen. Thesari në vazhdim mban një portofol aktivesh afatshkurta likuide, të përbëra kryesisht nga investime afatshkurtra në letra me vlerë, hua dhe paradhënie për banka dhe instrumenta të tjerë ndërbankare për t'u siguruar se ekziston likuiditeti i mjaftueshëm brënda Bankës në tërësi. Pozicionimi ditor i likuiditetit monitorohet rregullisht nga testimet të cilat mbulojnë kushtet normale dhe jo-normale të tregut. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt rishikimi dhe aprovimi nga ALCO. Raportet ditore përmbajnë pozicionin e likuiditetit të Bankës dhe degeve të saj. Një raport përmbledhës i cili përfshin çdo përjashtim për çdo veprim të marrë, paraqitet rregullisht tek ALCO.

Aktivitet dhe detyrimet financiare të Bankës sipas maturitetit

Tabela e mëposhtme shfaq aktivitet dhe detyrimet sipas maturitetit më 31 dhjetor 2017:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shume së 1 vit	Totali
Aktivitet						
Paraja dhe balancat me Bankën Qendrore	1,242,953	-	-	-	-	1,242,953
Investime në Letra me Vlerë	-	-	24,765	68,953	-	93,718
Rezerva e Detyruar	32,847	-	-	-	-	32,847
Hua dhe paradhënie për Klientët	-	-	269,473	-	-	269,473
Aktive të tjera	266	-	-	-	-	266
Totali i aktiveve	1,276,066	-	294,238	68,953	-	1,639,257
Detyrime						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	359,083	-	-	-	-	359,083
Ndaj klientëve	249,962	33,564	119,502	108,716	-	511,744
Detyrime të tjera	76,705	-	-	-	-	76,705
Totali i detyrimeve	685,750	33,564	119,502	108,716	-	947,532
Pozicioni Neto	590,316	(33,564)	174,736	(39,763)	-	691,725

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme shfaq aktivet dhe detyrimet sipas maturitetit më 31 dhjetor 2016:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shume së 1 vit	Totali
Aktivët						
Paraja dhe balancat me Bankën Qendrore	2,223,080	-	-	-	-	2,223,080
Investime në Letra me Vlerë	-	-	24,838	69,278	-	94,116
Rezerva e Detyruar Hua dhe paradhënie për Klientët	83,298	-	-	-	-	83,298
Aktive të tjera	358	-	310,876	-	-	310,876
Totali i aktiveve	2,306,736	-	335,714	69,278	-	2,711,728
Detyrime						
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	368,338	-	-	-	-	368,338
Ndaj klientëve	1,009,466	132,022	26,434	133,012	-	1,300,934
Detyrime të tjera	78,315	-	-	-	-	78,315
Totali i detyrimeve	1,456,119	132,022	26,434	133,012	-	1,747,587
Pozicioni Neto	850,617	(132,022)	309,280	(63,734)	-	964,141

Tabela e mësipërme shfaq rrjedhën e parasë të pa skontuar nga detyrimet financiare të Bankës bazuar mbi maturitetin kontraktual më të hershëm të mundshëm. Flukset e pritshme të mjeteve monetare e Bankës nga këto instrumenta nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga kjo analizë. Për shembull, depozitat me afat nga klientët pritet të mbajë një balancë të qëndrueshme ose në rritje.

4.3 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Bankës dhe instrumentave të tjerë financiar. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

(i) Menaxhimi i Rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin ndaj rrezikut të tregut midis portofoleve të tregtueshëm dhe jo-të tregtueshëm. Pozicioni i kursit të këmbimit trajtohet si pjesë e portofolit të tregtueshëm të Bankës me qëllim menaxhimit të rrezikut. Rreziku i tregut në tërësi i adresohet ALCO-s. Departamenti i riskut është përgjegjës për zhvillimin në detaje të politikave të menaxhimit të rrezikut (pjesë e rishikimit dhe aprovimit të ALCO-s) dhe për rishikimin ditor të implementimit të tij.

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Rreziku nga kursi i Këmbimit

Tabela e mëposhtme shfaq ekspozimin e Bankës ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

	LEK	USD	EURO	Të tjera	Total
Paraja dhe Balancat me Bankën Qendrore	17,551	1,214,638	9,617	1,147	1,242,953
Investime në Letra me Vlerë	93,718	-	-	-	93,718
Rezerva Ligjore	18,232	2,123	12,492	-	32,847
Hua dhe paradhënie për klientët	-	269,473	-	-	269,473
Totali i aktiveve	129,501	1,486,234	22,109	1,147	1,638,991
Detyrime					
Ndaj Bankave dhe Institucioneve Financiare	289,841	-	69,242	-	359,083
Ndaj Klientëve	288,449	103,766	118,023	1,506	511,744
Totali i detyrimeve	578,290	103,766	187,265	1,506	870,827
Pozicioni Neto	(448,789)	1,382,468	(165,156)	(359)	768,164
Pozicioni Kumulativ	(448,789)	933,679	768,523	768,164	
Në qoftë se Leku zhvlerësohet 10%		138,247	(16,516)	(36)	
Në qoftë se Leku zhvlerësohet 5%		69,123	(8,258)	(18)	
Në qoftë se Leku vlerësohet 10%		(138,247)	16,516	36	
Në qoftë se Leku vlerësohet 5%		(69,123)	8,258	18	

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Rreziku nga kursi i Kembimit (vazhdim)

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2016, sipas monedhave të emërtuara janë si më poshtë:

	LEK	USD	EURO	Të tjera	Total
Paraja dhe Balancat me Bankën					
Qendrore	19,237	2,179,122	23,555	1,166	2,223,080
Investime në Letra me Vlerë	94,116	-	-	-	94,116
Rezerva Ligjore	83,298	-	-	-	83,298
Hua dhe paradhënie për klientët	-	310,876	-	-	310,876
Totali i aktiveve	196,651	2,489,998	23,555	1,166	2,711,370
Detyrime					
Ndaj Bankave dhe Institucioneve Financiare	252,837	-	115,501	-	368,338
Ndaj Klientëve	343,388	861,891	93,896	1,759	1,300,934
Totali i detyrimeve	596,225	861,891	209,397	1,759	1,669,272
Pozicioni Neto	(399,574)	1,628,107	(185,842)	(593)	1,042,098
Pozicioni Kumulativ	(399,574)	1,228,533	1,042,691	1,042,098	
Në qoftë se Leku zhvlerësohet 10%		163,125	(18,584)	(59)	
Në qoftë se Leku zhvlerësohet 5%		81,562	(9,292)	(30)	
Në qoftë se Leku vlerësohet 10%		(163,125)	18,584	59	
Në qoftë se Leku vlerësohet 5%		(81,562)	9,292	30	

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(Shumat janë shprehur në '000 Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

Mesatarja e ri-vendosjes së cmimit për kategoritë e vecanta të aktiveve financiare dhe detyrimeve të Bankës më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Total
Aktive						
Para, Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	1,242,953	-	-	-	-	1,242,953
Investime në Letra me Vlerë	-	-	24,765	68,953	-	93,718
Rezerva Ligjore	32,847	-	-	-	-	32,847
Hua dhe Paradhënie për Klientët	-	-	269,473	-	-	269,473
Total Aktive	1,275,800	-	294,238	68,953	-	1,638,991
Detyrime						
Ndaj bankave dhe institucioneve financiare	359,083	-	-	-	-	359,083
Ndaj klientëve	249,962	33,564	119,502	108,716	-	511,744
Total	609,045	33,564	119,502	108,716	-	870,827
Pozicioni Neto	666,755	(33,564)	174,736	(39,763)	-	768,164

